REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 20.11.2023 | |
|---|---|---|
| Njësia Jedinica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 01-052/01-64767 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**ZYRA E KRYETARIT**

| | |
|---|---|
| **Datë:** | 20.11.2023 |
| **Referencë:** | |
| **Për:** | Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit<br>Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit |
| **Kopje:** | Diamant Bytyqi– Nënkryetar i Komunës<br>Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës |
| **Nga:** | Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsutlimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit. |
| **Lënda:** | Raport: Propozim-Rregullore për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit |

## Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739 e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikbërjes dhe vendimarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, me sektorin për marëdhënie me publikun kanë shpallur në:

**KONSULTIM PUBLIK**

Propozim-Rregullore për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konlsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Propozim Rregullorja si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

https://www.facebook.com/photo/?fbid=710773877743630&set=a.291330176354671

https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/

## Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziatat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna dhe në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës Njoftimin për Diskutim Publik të **Propozim-Rregullores për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit**

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit gjatë periudhes së konsultimit publik ka mbajtur disa debate të hapura publik me përfaqësuesit e bizneseve lidhur me projekt rregulloren për orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.
Është publikuar njoftimi me kohë për mbajtjen e debatit të parë publik.

https://www.facebook.com/photo/?fbid=712673127553705&set=a.291330176354671

Me daten 19.10.2023 duke filluar në ora 10:00 ka mbajtur debatin e parë në mënyrë që të ketë një rregullore gjithëpërfshirëse e të përshtatshme për bizneset, punëtorët dhe konsumatorët dhe pret propozime konkrete nga pjesëmarrësit sa i përket ndryshimeve që do të bëhen në këtë document.





| Metodat e Konsultimit | Datat/kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve |
|---|---|---|
| 1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike | 30 ditë pranohen | 35 |
| 2. Publikimi në ueb faqe | 30 ditë | |

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **35** pjesëmarrës, prej tyre **4** femra dhe **31** meshkuj.

Nërsa, me datë 20.10.2023 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit-debatit të dytë publik Propozim Rregullore për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

në linkun:

https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/10/Njoftim-per-debat-publik-i-protokoluar.pdf?fbclid=IwAR2wKPxUfa-NkhxSLXL8BeLIrL8fiQY-yfEs6f0FqbfYsplS1gunUS6ntlU

Po ashtu kjo projekt Rregullore është publikuar edhe në platformen e qeverise për konsultime publike në dy gjuhët zyrtare.

linku: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42113

Njoftimi për diskutim publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, po ashtu palët e interesuara janë njoftuar me daten, vendin, kohën për mbajtjen e takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik të Projekt-Rregullore për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit, si edhe informatat shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

Ndërsa takimi konsultativ është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. **02.11.2023 u** mbajt në sallën nr.2 në Komunën e Lipjanit duke filluar nga orëa 10:00.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Në ueb faqe:

https://www.facebook.com/komunalipjan/posts/pfbid021EMhcA5fQZAPqjqH79qFigVhy6pWj5H7gFx78UKvcP79PHD15rG8QEzvKrPW3vLcl

Konsultimi publik realizuar në kohën e paraparë dhe filloi në orën 10:00

Nën kryesimin e Valon Pacolli kryesues i komisionit për hartimin e kësaj rregullore u hap takimi me ç 'rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falënderuar për pjesëmarrje si dhe prezantoi anëtarët e komisionit të cilët hartuan draft rregulloren në fjalë:

1. Valon Pacolli, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryesues i Komisionit
2. Rexhep Rexhepi, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar i Komisionit
3 .Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore ,anëtare e Komisionit
4. Bedri Hetemi, Inspektor i Tregut , anëtar i komisionit
5. Shqipe Rexhepi, Zyrtare ligjore në Drejtoratin e Inspektoratit, anëtare e komisionit
6. Fitore Berisha , Zyrtare në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare e Komisionit
7. Linda Shahini, Zyrtare në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim,

Të pranishsëm e tjerë janë përfaqësuesit e bizneseve të ndryshme dhe qytetarë të Komunës së Lipjanit.

Debatin publik e hapi Valon Pacolli, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, njëherit edhe Kryesues i Komisionit i cili prezentoi dhe lexoi në tërësi Draftin e fundit të plotësuar në formë elektronike para të gjithë të pranishmëve, ku ka theksuar se aktualisht kjo rregullore është në fazën e konsultimeve me publikun dhe planifikohet të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e radhës së Kuvendit Komunal.

Ai sqaroi dhe informoi të pranishmit se konsultimi publik do të mbyllet me datën 13.11.2023 dhe deri me atë datë subjektet e biznesit apo qytetarët e interesuar mund të dërgojnë komentet e tyre me shkrim.

| Metodat e Konsultimit | Datat/kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve |
|---|---|---|
| 3. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike | 30 ditë pranohen | 24 |
| 4. Publikimi në ueb faqe | 30 ditë | |

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **24** pjesëmarrës, prej tyre **4** femra dhe **20** meshkuj.

Kryesuesi Pacolli ka thënë para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë rregullore e cila pritet të miratohet në seancën e radhës së Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth dispozitave të kësaj Projekt Rregulloreje.




Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë qështje, duke përfshirë orarin e punës gjatë javës dhe festave zyrtare si dhe nevoja të tjera për fleksibilitet në raste emergjente.






Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar sqarime rreth këtij dokumenti.

| Temat e Konsultimit | Komentet | Kush ka komentuar | Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara | Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|---|---|
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Ka kërkuar sqarim rreth nenit 10 paragrafit 1.5 përkitazi me festat zyrtare, si dhe kërkoi sqarime se a do të ketë ndryshime të orarit për ndonjë sezonë të caktuar . | **Mentor Borovci nga Supermareketi "Albi Comerc"** | Përkitazi me nenin 10 paragrafi 1.5 u dha sqarimi nga Komisioni se për këto veprimtari ekonomike në bazë të vlerësimit mund të vendosin të punojnë ose jo në ndonjë festë zyrtare.Të pranishmit u sqaruan se me nenin 30 të kësaj Projekt Rregullore i është lënë në kompetencë Kryetarit të Komunës që për ndonjë sezonë të caktuar në bëjë ndryshimin e orarit të punës. | Komenti u pranua plotësisht |
| Propozim Rregulloren për orarin e | Kërkoi të informohej se kur do të hy në fuqi kjo | **Mentor Borovci nga** | I lartëcekuri u njoftua nga Komisioni se | Komenti u pranua plotësisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Draft Rregullore si dhe për taksën prej 5 eurosh a duhet ta paguhet çdo herë që paraqitet kërkesë për zgjatjen e orarit p.sh çdo vikend. | **Supermareketi "Albi Comerc"** | kjo Propozim Rregullore ende është në fazën e konsultimit dhe do të hyj në fuqi pas miratimit në Kuvendin e komunës ndërsa taksa do të paguhet siq përcaktohet me Rregullore. | |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Kërkon që edhe marketet dhe restorantet që funksionojnësi pjesë e integruar e pompave të derivateve të punojnë me orarin e njëjtë të marketeve dhe restoranteve si dhe kërkojë që Kompanitë publike e veqanarisht ato që merren me pastrimin e qytetit të mos punojnë në orët e vona të natës pasi zhurma e makinerive të tyre e prish qetësinë e qytetit. | **Rexhep Sopa përfaqësues i biznesit "Rexha Bau"** | Komisioni sqaroi se në të gjitha shtetet e botës marketet që funsionojnë si pjesë e integruar e pompave të derivative punojnë më gjatë se marketet tjera. | Komenti nuk u pranua |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive | Kërkoi që mos të ketë kushtëzime por të ketë liri të tregut. Ai | Skender Kozhani pronar i biznesit "Markaman", | Komisioni sqaroi se një pjesë e madhe e bizneseve | Komenti nuk u pranua. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ekonomike në Komunën e Lipjanit | gjithashtu theksoj si problematikë që barnatoret që janë kujdestare i rrisin çmimet. | | kanë kërkuar që Rregullorja të fuqizohet përsëri ndërsa rreth çmimeve të barnatoreve u sqarua se nuk është në kompetencë të komunës ti ndryshojë çmimet | |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | E kundërshton që e diela të jetë ditë pushimi për marketet sidomos marketet e mëdha me shumë punëtorë pasi konsideron se shkakton destabilitet pasi nëse gjatë sezonës punohet ditën e dielë ne fillimisht duhet ta ulim numrin e punetoreve pastaj gjate sezones ta rrisim pastaj ekziston rreziku që pas liberalizimit të vizave gjatë sezonës verore të na ikin punëtorët. | **Ekrem Dili përfaqësues i "Super Vivës"** | Komisioni sqaroi se duhet të vihen parasysh edhe të drejtat e punëtorëve që kanë nevojë të kenë një të diele pushim. | Komenti nuk u pranua |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Të merret parasysh dhe të konsiderohet domosdoshme që e diela të jetë ditë pushimi pasi do të ishte një përkrahje për punëtorët që | **Hysni Ibrahimi përfaqësues i Biznisit DPT "Hysi"** | Komisioni sqaroi se me dispozitat e Rregullores është përcaktuar që e diela të jetë ditë pushimi | Komenti u pranua Plotësisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | mos të ikin jashtë vendit. | | për shumicën e veprimtarive ekonomike | |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | kundështon që të ketë dallim të orarit mes marketeve që punojnë në kuadër të pompave të derivateve dhe marketeve dhe qendrave tregtare dhe gjithashti kërkoj se ahtu si barnatoret edhe marketet të punojnë me rotacion pra të jetë një kujdestare . | **Ekrem Dili përfaqësues i "Super Vivës"** | Komisioni sqaroi në të gjitha shtetet e botës marketet që funsionojnë si pjesë e integruar e pompave të derivative punojnë 24 ore ndërsa me këtë Projekt Rregullore parshihet deri ne 0ra 24:00. Sa i përket rotacionit të marketet u konsiderua që do të jetë vështirë i realizueshëm | Komenti nuk u pranua |
| | | **Komentet që janë pranuar përmes postes elektronike** | | |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Përshendetje kam një lidhur me veprimtarinë e punës për marketet qe të dielave me punu prej 9 deri ora 2 ma mir kishte me qenë që te dielen te gjithë dita të jetë pushim, kem nevoj kejt edhe puntorët edhe shefat ju kisha lut me marr në konsiderim. | **Altin Zejnullahu, qytetarë** | Komisioni sqaroi se me dispozitat e Rregullores është përcaktuar që e diela të jetë ditë pushimi për shumicën e veprimtarive ekonomike | Komenti u pranua Plotësisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Pershendetje jam Barbershop Argjendi punoj dhe veproj në qytetin e Lipjanit, në pamundësi teë marr pjesë fizikisht në mbledhjen e organizuar në sallen e kuvendit, unë përmes emailit shprehu iden që orari i punes të jetë 09:00-21:00 për arsye se është më i përshtatshëm për neve dhe klientët si dhe e diela të jetë dite pushimi por nese smundet te jetë pushim te behet orar i plot pasi qe orari 09:00-14:00 është shumë i papërshtatshëm shpresoj që propozimi im të merret parasysh edhe shpresoj ta merrni vendimin ma të mirë të mundshëm. | **Argjend Jahiri-Barbershop Argjendi** | Komisioni sqaroi se me dispozitat e Rregullores për veprimtarinë e Barbershop është paraparë që e diela të jetë ditë pushimi gjatë sezonës dimërore, ndërsa gjatë veres do të punohet edhe në diten e diel. | Komenti u pranua Pjesërisht |
| Propozim Rregulloren për orarin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit | Lidhur me projekt rregulloren e orarit të veprimtarive ekonomike, ne emer te "Top Market A&B Sh.p.k" ne Lipjan, propozoj që orari i punes të ndryshoj, ku marketet të kenë pushim të plotë ditëve të | **Bekim Kryeziu "Top Market A&B"** | Komisioni sqaroi se me dispozitat e Rregullores është përcaktuar që e diela të jetë ditë pushimi për shumicën e veprimtarive ekonomike | Komenti u pranua Plotësisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | diela. Me bisedat me shumë markete ne gjithë komunën e Lipjanit, mbi 95 % janë për diten e diele, ditë pushimi. Prandaj besojmë dhe shpresojmë që te keni parasysh gjatë hartimit te rregullores se re ne lidhje me orarin e pushimit per veprimtaritë ekonomike. | | edhe për marketet në këtë rast. | |

**Shtojë: Lista e pjesëmarrësve**

**Bukurie Zejnullahu-Jashari**
**Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve në Takimin publik me datën 19.10.2023 në ora 10;00 në Sallën e Kuvendit të Komunës për të diskutuar për Projekt-Rregulloren për orarin e punës të veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit

19.10.2023

| | EMRI | MBIEMRI | NËNSHKRIMI |
|---|---|---|---|
| 1 | Fadil - Zvëllezi | Sopa | [signature] |
| 2 | Kadënsha Ferati | | [signature] |
| 3 | Rinor Hernati | | [signature] |
| 4 | Shkelzim | Olluri | [signature] |
| 5 | Nevkie | Husaj | [signature] |
| 6 | Jehona | Shala | [signature] |
| 7 | Hysri | Ibrahimi | [signature] |
| 8 | Hamdi | Rrustemi | [signature] |
| 9 | Rexhep | Sopa | [signature] |
| 10 | Visar | Hasani | [signature] |
| 11 | Ilriz Hasani | —//— | [signature] |
| 12 | Jonuz Sela | | [signature] |
| 13 | Nexhmedin Rexhepi | Rexhepi | [signature] |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 14 | EKREM | DILI | |
| 15 | Altin Zejnullahu | | |
| 16 | DARDAN MEHMETI | | |
| 17 | Faton | Selaj | |
| 18 | Lavdije | Sejdiu | |
| 19 | Avan | AZEMI | |
| 20 | Refki | Agushi | |
| 21 | Rinor | Gadraku | |
| 22 | SHPEJTIM | IBRAHIMI | |
| 23 | Brahim | Prahmani | |
| 24 | ISMAJL | Ejupi | |
| 25 | MENTOR | MAHOLLI | |
| 26 | Premtim | Azemi | |
| 27 | NEHAT | TAFA | |
| 28 | BUJAR RRUSTEMI | "BLEONI" | |
| 29 | LIRIM SADIKU | AGRO-EKO | |
| 30 | ISAK | TAFA | |
| 31 | Ikënder Kochomi | Markamani | |
| 32 | HAMIT-SOPA | URBAN CENTER | |
| 33 | ARDIAN BYTYQI | MAKSI | |
| 34 | SHKURTE FAZLIU | FRESH SHOP STORE | |
| 35 | ARMEND LUMA | KRAISHTË | |
| 36 | | | |
| 37 | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Rregulloren për Orarin e Veprimtarive Ekonomike me datë 02.11.2023 ora 10;00.

| Nr. | Emri Mbiemri | Emërtimi i Biznesit | E-maili | Telefoni | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nevzie Avdiaj | Viva Fresh | | 049-998-272 | |
| 2 | Gentiana Rexhepi | "CAPRILLA" Market | | 048 300-363 | |
| 3 | Mentor Boroci | ALBI GROUP | mentor.boroci@albi.com | 048 794-185 | |
| 4 | Rexhep Sopa | Rexha Bag Sh.p.k | rexhepsopa2@gmail.com | 043 778-808 | |
| 5 | Hysri Ibrahimi | Hysi - IB. | hysi0044375@gmail.com | 044-375 456 | |
| 6 | Hamdi Rrustemi | N.T.P. Fisniku Lipjan | | 044316380 | |
| 7 | Afrim Thaqi | NTP. Diona Comerc | | 044 206 951 | |
| 8 | Ekrem Dili | Super Viva Shpk | | 048-802-565 | |
| 9 | Nexhmedin Rexhepi | Superviva | | 044 516 824 | |
| 10 | Imer Jahiri | Ardhmeri-Market | | 044-206-779 | |
| 11 | Brahim Brahimaj | Eli Market | | 044647913 | |
| 12 | Fremtim Azemi | Shpk Supermarket Alea | | 044-698-509 | |
| 13 | Bujar Rrustemi | D.P.T Bleoni | | 049 654100 | |
| 14 | Islam Tafa | Tafa-Tor | | 044313429 | |
| 15 | Nehat Tafa | Tori Centr | | 044554070 | |
| 16 | Lavdije Sejdiu | ~~Sejdiu~~ Diani Market | | 044 598341 | |
| 17 | Shkurte Fazliu | Fresh Stor | | | |
| 18 | Shpetim Ibrahimi | Market Shpetimi | | 045760 519 | |
| 19 | Mentor Maholli | Pemë dhe perime Temenstori | | 045 886 674 | |
| 20 | Fadil Miftari | Interex | ~~fadilmiftari@~~ | 048-160-703 | |
| 21 | Albion Rekaj | Lulishtja Nimi | | 045-461-919 | |
| 22 | Albion Rekaj | Jewelry House | | 049-919-111 | |
| 23 | Hamit Sopa | Urban Center | | 044-454468 | |
| 24 | Skender Korkuti | Markaman | | 044316395 | |
| 25 | | | | | |
| 26 | | | | | |
| 27 | | | | | |
| 28 | | | | | |
| 29 | | | | | |
| 30 | | | | | |
| 31 | | | | | |
| 32 | | | | | |
| 33 | | | | | |
| 34 | | | | | |
| 35 | | | | | |